

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik të kategorisë “Lektorë” në Departamentin e Inxhinierisë Fizike.

Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Lektorë” pranë Departamentit të Inxhinierisë Fizike në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë së paku gradën shkencore “Doktor” në Fizikë, Inxhinieri Fizike të fituar brenda ose jashtë vendit;
2. Të zotërojnë diplomë të integruar të sistemit 5 vjeçar ose sistemit 3 + 2 (Bachelor +Master i Shkencave) të studimeve në Fizikë, Inxhinieri Fizike, brenda ose jashtë vendit me notë mesatare së paku 8:00;
3. Të kenë aktivitet mësimor kërkimor në fushën “Energjia dhe Mjedisë”;
4. Të kenë përvojë akademike në mësimdhënie pranë Departamentit të Inxhinierisë Fizike;
5. Të kenë dy letra reference nga punëdhënësit e fundit apo personalitete të fushës.
6. Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe punës në grup.

B. 1 (një) vend pune për personel akademik të kategorisë “Lektorë” në Departamentin e Inxhinierisë Matematike.

Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Lektorë” pranë Departamentit të Inxhinierisë Matematike në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë së paku gradën shkencore “Doktor” në Matematikë apo Inxhinieri Matematike të fituar brenda ose jashtë vendit;
2. Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë (Master i Shkencave) në Inxhinieri Matematike pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në UPT, ose diplomë të ciklit të dytë në Matematikë apo Inxhinieri Matematike dhe Informatikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në UT ose degë ekuivalente me to në universitete jashtë vendit (diploma e ekuivalentuar pranë MAS);
3. Diplomë të matematikës speciale 5 vjeçare (programi i vjetër i studimit) ose diplomë ekuivalente me të në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në UT.
4. Të kenë përfunduar studimet me notë mesatare mbi 8 (në secilin nga ciklet e studimit Bachelor dhe Master i Shkencave) për studentët që kanë përfunduar studimet në Shqipëri ose të ekuivalentuar mbi 8 për studentët që kanë përfunduar studimet jashtë Shqipërisë;
5. Të kenë përvojë akademike dhe mësimdhënie;
6. Të kenë dy letra reference nga punëdhënësit e fundit apo personalitete të fushës.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Dokumentin e fitimit të gradës shkencore “Doktor”;
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **22.09.2023** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.